



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 6, date 19.09.2019

Për vërtetimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Shkoder, Z. Oltion Luli

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 19.9.2019, me propozim të Komisionit të Mandateve të Këshillit, bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 1, 2, 3, neni 50, pika 1, 2, neni 54, shkronja j, neni 55, pika 3, mbështetur në vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 76 dt. 26.07.2019, “Për shpërndarjen e mandateve për koalicionet zgjedhore dhe partitë politike brenda tyre”, Vendimin e KQZ nr. 1097, dt. 27.07.2019, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar për organet e qeverisjes vendore dt. 30 qershor 2019”, me propozim të komisionit të mandateve dhe rregullores, pasi shqyrtoi mandatin e z. Oltion Luli në funksionin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Shkodër si përfaqësues politik i Partisë Socialiste të Shqipërisë, për arsye të mungesës së tij në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak Shkodër dt. 19.08.2019.

V E N D O S I

1. Miratimin e raportit të komisionit të mandateve mbi vlefshmërinë e mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Shkoder, Z. Oltion Luli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 19.9.2019

Shpallur në datën 19.9.2019

K R Y E T A R E

Brisela KADIJA

